



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I ARTEVE  
SENATI AKADEMIK**

**VENDIM**

Nr. 02, datë 10/01/2020

**MBI**

**“MIRATIMIN E NUMRIT TË RI RENDOR TË DIPLOMAVE, TË OFRUARA NGA  
UNIVERSITETI I ARTEVE, PAS REGJISTRIMIT TË FORMËS SË RE TË  
DIPLOMAVE”**

Senati Akademik i Universitetit të Arteve, mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 për “Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe në udhëzimin e Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë me nr. 25, datë 10.11.2017 “Për regjistrimin e formave të diplomave dhe certifikatave në regjistrin shtetëror të diplomave dhe certifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor” (i ndryshuar), Urdhrit Nr. 821, datë 26.12.2018 “Për riorganizimin e disa programeve të studimit të ciklit të dytë në Universitetin e Arteve”, Urdhrit Nr. 512, datë 24.10.2019, “Për riorganizimin e disa programeve të studimit në Universitetin e Arteve” si dhe shkresës së Qendrës së Shërbimeve Arsimore me Nr. 3095/65 Prot. datë 19.09.2018 “Për regjistrimin e formave të diplomave” me Urdhrat përkatës për secilin program studimi nga Nr. 130, datë 19.09.2018 deri në Nr. 161, datë 19.09.2018 , pasi e diskutoi me votim të hapur,

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e numrit të ri rendor të diplomave të ciklit të dytë të studimeve me kohë të plotë Master, të ofruara nga Universiteti i Arteve, pas regjistrimit të formës së re të diplomave sipas Urdhrave përkatës për secilin program studimi të miratuara nga QSHA.
2. Pas regjistrimit të formës së re të diplomës me shtesën dhe Mësuesi, për të gjitha programet e studimit të ciklit të dytë Master i Arteve, Master i Shkencës dhe Master Profesional, të ofruar nga Universiteti i Arteve, numri rendor i diplomave për secilin program studimi, do të fillojë nga numri 1(një) dhe do të ritet në mënyrë progresive në vazhdim.
3. Numri i identifikimit të fillojë me vitin akademik kur janë riorganizuar programet e studimit sipas VSA nr. 27, datë 05.10.2017; VSA nr. 28, datë 05.10.2017; VSA nr. 29, datë 05.10.2017, me numrin shifror 17, sipas Udhëzimit Nr. 25, datë 10.11.2017 të MASR. Studentët që janë regjistruar në vitin 2016 dhe kanë kryer të plotë studimet në programet e riorganizuara me mësuesinë të vendoset viti i fillimit të studimeve me numrin shifror 16, dhe tu jepet diploma me shtojcën dhe mësuesi.
4. Për secilin program studimi të ofruar nga fakultet e UART të bëhen regjistra të rinj sipas modelit të përcaktuar në shtojcën 1, në shtojcën 2 dhe në shtojcën 3 të këtij vendimi.

